

## Vështirësit në të nxënë

### Çrregullimet e komunikimit

#### Klasifikimi

##### Çrregullimet e gjuhës ekspresive

- ? Çrregullimi gjuhësor i përzier receptivo-ekspresiv
- ? Çrregullimi fonologjik
- ? Belbëzimi

##### Çrregullimet e gjuhës ekspresive

Dëmtohet përdorimi komunikues i gjuhës. Individu nuk mund t'i hedhë idetë në fjalë, dëmtohet përzgjedhja e fjalëve, ndërtimi i fjalisë, përfrazimi, tregimi dhe shpjegimi.

##### Fjalori është dukshëm i kufizuar

- ? Bëhen gabime në kohët e gjuhës
- ? Pasja e vështirësive në rikujtimin e fjalëve
- ? Pasja e vështirësive në krijimin e fjalive me gjatësi apo kompleksitet të përshtatshëm për zhvillimin.

Afro 1 në 1000 fëmijë kanë një formë të rënde të çrregullimit të gjuhës ekspresive. Meshkujt preken 3 deri në 4 herë më shpesh se femrat. Nëse është e pranishme PM, vështirësitë gjuhësore janë më tepër sesa ato që zakonisht lidhen me këto probleme. Inteligjenca përcaktohet me matjen joverbale të IQ. Duhet kryer testi i saktësisë së dëgjimit.

Prindërit zakonisht shqetësohen në kohën që fëmija arrin moshën 2-3 vjeçare, kur fëmija mund të duket i zgjuar, por nuk flet ende ose ka fjalor të pakët. Periudha nga 4-7 vjeç është thelbësore. Rreth 8 vjeç vendoset njëri nga të dy ecurit e zhvillimit. Fëmija mund të bëjë progres drejt të folurit pothuajse normal, duke ruajtur vetëm defekte të imëta ose në të kundërt progresi mund të jetë i pakët.

Problemet në gjuhën ekspresive kanë si pasojë ndrojtjen, tërheqjen e fëmijës dhe labilitetin emocional.

##### Çrregullimi gjuhësor i përzier receptivo-ekspresiv

Dëmtohet si kuptimi, ashtu edhe të shprehurit. Ka vështirësi në kuptimin e fjalëve dhe fjalive. Në rastet e lehta mund të ketë të kuptuar të ngadaltë të fjalive të komplikuar. Në rastet e rënda këto vështirësi mund të shtrihen në fraza apo fjali më të thjeshta. Është më e rëndë dhe më problematike nga ana sociale sesa çrregullimi i gjuhës ekspresive

Çrregullimi gjuhësor i përzier receptivo-ekspresiv dallon nga:

##### Afazia, e cila nuk është çrregullim i zhvillimit, por humbje e funksioneve paraekzistuese të gjuhës

- ? Deficitet e tjera të fituara (zakonisht të shkaktuara nga trauma neurologjike apo sëmundje)
- ? Në adoleshencë individët me çrregullime gjuhësore të përzier receptivo-ekspresiv mund të përngjaj fëmijëve autike. Megjithatë shfaqin aftësi më të mira sociale, vetëdije për ambientin dhe komunikim joverbal.

##### Çrregullimi fonologjik

Probleme të shqiptimit, sidomos për tingujt e fituar vonë. Dëmtimi në artikullim dhe në të mësuarin e tingullit përfshin zëvendësimin e tingullit (psh përdorimi i t për k), heqjen (psh bashkëtingëlloret finale), shtesat e një tingulli tjetër dhe shtrembërimet. E folura mund të duket si ?e folur bebeje?

Që heret në zhvillim, tingujt e foshnjeve janë të ngjashme mes kulturave, me bazë në proceset biologjike. Ndërsa fëmija mëson tingujt e gjuhës së vendit, prodhimi i tingujve ndryshon dhe bëhet specifik për kulturë. Prodhimi i mëtejshëm i tingujve të të folurit varet në zhvillimin e kontrollit motor të të folurit (gjuha, buzët, qiellza, larinksi, nofulla, muskujt e frymemarrjes), perceptimin dëgjimor (bashkëtingëlloret dhe zanoret, ritmi, intensiteti, intonacioni). Në moshën 8 vjec fëmija ka fituar në mënyrë tipike të gjithë tingujt e gjuhës.

Mosha e diagnostikuar është zakonisht rreth 3 vjec, por crregullimi mund të shfaqet më herët ose më vonë, në varësi nga rëndesa. Afro 6% e djemve dhe 3% e vajzave kanë crregullim fonologjik, por problemet e artikulimit bëhen më pak prevalente me rritjen në moshe.

Shërimi spontan ndodh zakonisht në moshën 8 vjec, por terapia e të folurit individuale apo në grup mund të ndihmojë në shpejtësinë dhe arritjen e plotë të zhvillimit të të folurit.

### Belbëzimi

Ndërprerje e rrjedhes normale të të folurit, e karakterizuar nga hezitime të pavullnetshme dhe të crregullta, zgjatje, përsëritje apo bllokime në tinguj, bashkëtingëllore apo fjalë.

Vihen re:

Përsëritje të tingujve dhe rrokjeve

- ? Zgjatje të tingujve
- ? Pasthirrma
- ? Fjalë të thyera (psh pauza brenda një fjale)
- ? Bllokim i dëgjueshëm apo i heshtur (pauza të mbushura ose jo në të folur)
- ? Parafrazime (zëvendësime të fjaleve për të shmangur fjalët problematike)
- ? Fjalët shqiptohen me tension fizik të tepruar
- ? Përsëritje të fjalëve të plota njërrrokëshe (psh unë-unë-unë ?unë e shoh atë)

Në 50-80% të rasteve ndodh përmirësimi spontan dhe 1% e adoleshentëve dhe të rriturve vazhdojnë të plotësojnë kriteret për këtë crregullim. Meshkujt preken më tepër në raport 3:1 deri 4:1. Shpesh fillon 2-4 vjec ose më rrallë 5-7 vjec. Afro 2-4% e fëmijëve e kanë këtë crregullim gjuhësor.

Për foshnjat belbëzimi është zakonisht simptom kalimtare e zhvillimit që zgjat më pak se 6 muaj, por 25% e personave me fillim të hershem të simptomave kanë belbezim të qëndrueshëm përtej moshës 12 vjec.

Fëmija mund të ndihet i turpëruar, i zemëruar, fajtor, tallet nga shokët. Shmangia e të folurit dhe imazhi i ulet për veten mund të ndikojnë në zhvillimin gjuhësor dhe social dhe të cojnë në probleme akademike. Tek belbëzimi ankthi krijon përkeqësim të dukshëm në shpejtësinë e ritmit.

Terapia e të folurit përfshin disa elemente të terapisë së sjelljes: modifikimi i ambientit dhe faktorëve në bisedë që nxisin belbëzimin, relaksimi, kontrolli i ritmit, rritje e vetë-vleresimit. Metodrat: imitimi, luajtja e roleve, praktikimi në të folur (me lexim, lexim në kohë, bisedim), folja në ambiente të ndryshme dhe me njerëz të ndryshëm.